

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
ZYRA VENDORE TIRANE  
NR. 1000 REP.  
NR. 391 KOL.

### MARRËVESHJE SIGURUESE

Ndërmjet

**COSMOTE MOBILE  
TELECOMMUNICATIONS S.A.**  
në cilësinë e Barrëdhënësit

dhe

**FIRST INVESTMENT BANK AD**  
në cilësinë e Barrëmarrësit

dhe

**ALBANIA TELECOM INVEST AD**  
në cilësinë e Pranuesit

Sot, me 17/04/2019 në Tiranë përpara meje noteres E. Hoxha, u paraqiten personalisht palet e meposhtme, te cilet deklarojne përpara meje se me vullnetin e tyre te lire lidhin kete Marreveshje Siguruese si me poshte:

Kjo Marrëveshje Siguruese (referuar në vijim si "Marrëveshja" ose "Marrëveshja Siguruese" lidhet në Tiranë midis:

[\*]

**COSMOTE MOBILE  
TELECOMMUNICATIONS S.A.**, shoqëri aksionare, e regjistruar dhe që vepron në bazë të ligjeve të Republikës së Greqisë, me numër regjistrimi 2410501000, me seli dhe adresë: 99, Kifissias Blvd, 15124, Maroussi, Greqi, përfaqësuar me Prokure Nr. 5273 te dates 21.03.2019 nga Z. Kristaq Profkola, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me date 26.12.1980, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. 030570133 dhe nr.personal: 101226121N, (referuar në vijim si "COSMOTE" ose "Barrëdhënësi";

**FIRST INVESTMENT BANK AD**, shoqëri aksionare, e regjistruar dhe që vepron në bazë të ligjeve të Republikës së Bullgarisë, me numër regjistrimi 831094393, me seli dhe adresë: 37 Dragan Tsankov Blvd., 1797 Sofia, Bullgari përfaqësuar nga nepermjet prokures se posacme

REPUBLIC OF ALBANIA  
TIRANA NOTERY CHAMBER  
TIRANA LOCAL OFFICE  
NR. 1000 REP.  
NR. 391 KOL.

### SECURING CHARGE AGREEMENT

Between

**COSMOTE MOBILE  
TELECOMMUNICATIONS S.A.**  
as Chargor

and

**FIRST INVESTMENT BANK AD**  
as Chargee

and

**ALBANIA TELECOM INVEST AD**  
as Acceptor

On this day, on 17/04/2019, in Tiranë, in front of me the Public Notary E. Hoxha were personally presented the following parties who in their free will sign this Securing Charge agreement as per below:

This Securing Charge Agreement (hereinafter as the "Agreement" or the "Securing Charge Agreement" is made in Tirana by and between:

[\*]

**COSMOTE MOBILE  
TELECOMMUNICATIONS S.A.**, a joint-stock company registered and duly existing under the laws of Greece, under company registration number 2410501000, with its seat and place of management at: 99, Kifissias Ave, 15124, Maroussi, Greece, represented with Power of Attorney No.5273 dated 21.03.2019 by Mr. Kristaq Profkola, Albanian citizen, born in Tirana on 26.12.1980, holder of the identification document no. 030570133 and personal number no. 101226121N (referred to as "COSMOTE" or the "Chargor");

**FIRST INVESTMENT BANK AD**, a joint-stock company registered and validly existing under the laws of Republic of Bulgaria, under company registration number 831094393, with its seat and address at: 37 Dragan Tsankov Blvd., 1797 Sofia, Bulgaria, represented by way

date 12.04.2019 nga z. Bozhidar Mihaylov Todorov, shtetas Bullgar, me dokument identifikimi nr. 646595226, numer personal nr.7406266401, dhe z. Erion Doko, shtetas shqiptar, dokument identifikimi nr. BB1965528, numer personal nr. H80322101K, (I quajtur ne vijim si “FIB” ose “Barrëmarësi”); dhe

**ALBANIA TELECOM INVEST AD**, shoqëri aksionare, e regjistruar dhe që vepron në bazë të ligjeve të Republikës së Bullgarisë, me numër regjistrimi 205404422, me seli dhe adresë: 82, Patriarch Evtimii Blvd., 1463 Sofia, Bullgari, përfaqësuar nga Z. Enkelejd Seitllari, shtetas shqiptar, lindur më 09.08.1984, në Gështenjas, Pogradec, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. 028962565 dhe nr. Personal I40809047N, (I quajtur ne vijim si “ATI” ose “Pranuesi”),

dhe secilit prej subjekteve ligjore të renditura më sipër, quajtur veçmas si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”, u paraqitën përpara meje, Enkeleida Hoxha - noter publik me numër license nr.217 date 03.04.1999, dhe deklaruan me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë se dëshirojnë të lidhin këtë marrëveshje siguroese (“Marrëveshja”):

**DUKE PATUR PARASYSH SE:**

(A) Në mbështetje të Marrëveshjes së Huasë me numër 000LD-L-000900/05.03.2019 të rregulluar nga legjislacioni bullgar, lidhur më 05 Mars 2019, midis FIB-së, në cilësinë e Huadhenesit (siç përkufizohet në Marrëveshjen e Huasë) dhe ATI-së, në cilësinë e Huamarrësit (siç përkufizohet në Marrëveshjen e Huasë), të dy palët e lartpërmendura kanë rënë dakord, ndër të tjera, që FIB t'i vërë në dispozicion ATI disa hua në shumën totale prej Euro 48.500.000 (dyzete e tete milion e peseqind mije euro), për qëllimet dhe sipas kushteve të parashikuara në Marrëveshjen e Huasë, ku njëra prej këtyre huave në shumën prej Euro 45.000.000 (dyzete e pese milion eurosh) (“Shuma e huase së Transaksionit”) të përdoret vetëm për qëllimin e blerjes nga ana e ATI se të paktën 99.76% të aksioneve (“Aksionet”) të Telekom Albania Sha (“Shoqëria”) nga COSMOTE (“Transaksioni”).

of Power of Attorney dated 12 April 2019 by Mr. Bozhidar Mihaylov Todorov, a Bulgarian citizen, holder of the identification document no. 646595226 and personal number no. 7406266401, and Mr. Erion Doko, an Albanian citizen, holder of the identification document no. BB1965528 and personal number no. H80322101K (referred to as “FIB” or the “Chargee”); and

**ALBANIA TELECOM INVEST AD**, a company registered and validly existing under the laws of Republic of Bulgaria, under company registration number 205404422, with its seat and address at: 82, Patriarch Evtimii Blvd., 1463 Sofia, Bulgaria, represented by Mr. Enkelejd Seitllari, Albanian citizen, born on 09.08.1984, in Gështenjas, Pogradec, Albania holder of ID No. 028962565, with personal No. I40809047N hereinafter called (“ATI” or the “Acceptor”),

and each one of the legal entities listed above individually referred to as a “Party” and collectively as “Parties”, are present in front of me, Enkeleida Hoxha - public notary licensed under number no.217 dated 03.04.1999, and declare that, with their free and full will, want to enter into this securing charge agreement (the “Agreement”):

**WHEREAS:**

(A) Pursuant to a Bulgarian law governed Facility Agreement dated 5 March 2019, with no. 000LD-L-000900/05.03.2019 (the “Facility Agreement”) concluded between FIB, as Lender (as defined in the Facility Agreement), and ATI, as Borrower (as defined in the Facility Agreement), FIB and ATI have agreed, inter alia, FIB to make available to ATI certain loans in the aggregate amount of EURO 48.500.000 (fortyeight million and five hundred thousand Euro), for the purposes and on the terms provided in the Facility Agreement, one such loan in the amount of EUR 45.000.000 (fortyfive million euro) (the “Transaction Loan Amount”) being solely for the purposes of ATI to acquire at least 99.76% (the “Shares”) of the shares in Telekom Albania Sh.a. (the “Company”) from COSMOTE (the “Transaction”).

(B) Për qëllimet e transaksionit, COSMOTE, në cilësinë e pales shitese, dhe ATI në cilësinë e pales blerese kanë lidhur një Marrëveshje për Shitblerjen e Aksioneve më 15 Janar 2019 ("**Marrëveshja e Shitblerjes**") sipas kushteve të së cilës, COSMOTE i transferon shoqerise ATI titullin e pronesisë mbi Aksionet dhe kundrejt tyre përfiton vlerën përkatëse.

(C) Sipas kushteve të Marrëveshjes së Shitblerjes, FIB transferoi Shumën e Huase së Transaksionit në Llogarinë e Garancise (Escrow), siç përkufizohet në Marrëveshjen e Garancise (Escrow) lidhur ndërmjet COSMOTE-s, FIB, ATI dhe Citibank London ("**Agjenti Escrow**"), më 17 prill 2019 ("**Marrëveshja Escrow**").

(D) Sipas kushteve të Marrëveshjes Escrow, Agjenti Escrow zhbllokon një shumë të barasvlefshme me Vlerën Fillestare (siç përkufizohet në Marrëveshjen e Shitblerjes), shuma e të cilës përfshin edhe një shumë që përfaqëson Shumën e huasë së Transaksionit për COSMOTE-n ("**Zhbllokimi i Shumës së huase së Transaksionit**") bëhet vetëm pas dërgimit të njoftimit të përbashkët të COSMOTE dhe ATI ("**Njoftimi i Përbashkët**") tek Agjenti Escrow, pas transferimit të titullit të pronesisë mbi Aksionet në emër të ATI.

(E) Parakushti i Zhbllokimit të Shumës së Huase së Transaksionit është që kjo Marrëveshje që lidhet për qëllimet e Krijimit të barres në formën e Barrës Siguruese (si përkufizohet më poshtë) mbi Aksionet e Barresuara (siç përkufizohen më poshtë) nga COSMOTE, në cilësinë e Barrëdhënësit, në favor të FIB, në cilësinë e Barrëmarrësit, barra siguruese e të cilit, në kuadrin e Marrëveshjes së Shitblerjes, pranohet nga ATI, në cilësinë e Pranuesit, si pronari i vetëm i ardhshëm ligjor dhe përfitues i të gjithë Aksioneve të Barresuara, për përmbushjen në kohë të detyrimeve të ATI-t sipas Marrëveshjes së Huasë dhe (pas transferimit të Aksioneve të Barresuara të ATI dhe Zhbllokimit të Huasë së Shumës së Transaksionit) të detyrimeve të çdo pale të detyruar në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë.

(F) COSMOTE e jep këtë barre në formën e Barrës Siguruese mbi Aksionet e

(B) For the purposes of the Transaction, COSMOTE, as seller, and ATI, as purchaser, have entered into a Share Sale and Purchase Agreement dated 15 January 2019 (the "**SPA**") pursuant to the terms of which COSMOTE will, subject to the terms of the SPA, transfer to ATI legal title over the Shares and COSMOTE will receive the consideration for the Shares.

(C) Pursuant to the terms of the SPA, FIB transferred the Transaction Loan Amount to the Escrow Account, as defined in the Escrow Agreement between COSMOTE, FIB, ATI and Citibank London (the "**Escrow Agent**") dated April 17, 2019 (the "**Escrow Agreement**").

(D) As per the terms of the Escrow Agreement, the Escrow Agent will release an amount equal to the Initial Consideration (as defined in the SPA), which amount shall include a sum representing the Transaction Loan Amount, to COSMOTE (the "**Release of the Transaction Loan Amount**") only upon a joint notice by COSMOTE and ATI (the "**Joint Notice**"), to be provided to the Escrow Agent following the transfer to ATI of the legal title over the Shares.

(E) It is a condition precedent to the Release of the Transaction Loan Amount that this Agreement shall be entered into for the purposes of Establishing security in the form of a Securing Charge (as defined below), over the Charged Shares (as defined below) by COSMOTE, as the Chargor, in favor of FIB, as the Chargee, which Securing Charge, in view of the SPA shall be accepted by ATI, as the Acceptor, as the future sole legal and beneficial owner of all of the Charged Shares, for the due performance of the obligations of ATI under the Facility Agreement and (following the transfer of the Charged Shares to ATI and Release of the Transaction Loan Amount) of the obligations of any other obligors under the Facility Agreement.

(F) COSMOTE is granting such security in



Barresuara (si përkufizohen më poshtë) në favor të FIB, vetëm dhe ekskluzivisht për qëllimin e Lehtësimit të Zhbllokimit të Shumës së Huasë së Transaksionit menjëherë pas transferimit të ATI të titullit të pronësive mbi aksionet e Barresuara.

**PALËT**, në detyrim ligjor, angazhohen dhe bien dakord si më poshtë:

**1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET**

**1.1 Përkufizimet**

Termat e përdorur kudo në këtë Marrëveshje (duke përfshirë edhe në Preambul) kanë kuptimet e mëposhtme:

“**Aksione të Barresuara**” janë Aksionet Ekzistuese apo Aksionet e Ardhshme.

“**Kompletimi**” përfshin transferimin e titullit të Aksioneve të Barresuara nga COSMOTE të ATI, regjistrimin e transferimit në QRA dhe përfundimin e ekstraktit përkatës.

“**Krijimi**” ose “**Perfeksionimi**” (përdoren në mënyrë të ndërkëmbyeshme) është përkatësisht krijimi dhe perfeksionimi i Barrës Siguruese (ose i çdo ndryshimi apo shtese të saj) lidhur me Aksionet e Barresuara, në përputhje me këtë Marrëveshje përmes:

- (a) regjistrimit të Barrës Siguruese në (A) regjistrin e brendshëm të aksioneve të Shoqërisë dhe (B) në RBS;
- (b) lëshimit të konfirmimit të regjistrimit dhe certifikatës përkatëse nga RBS-ja, që vërteton dhënien (ose ndryshimin apo shtimin) dhe regjistrimin e Barrës Siguruese objekt të kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (c) depozitimit të Marrëveshjes Siguruese në (A) QRA dhe (B) QKB.

“**Krijoj**”, “**Krijim**”, “**Perfeksionoj**” dhe “**Perfeksionim**” interpretohen sipas përkufizimit më lart. Palët bien dakord se COSMOTE bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta regjistruar këtë Marrëveshje dhe Barrën Siguruese objekt të kësaj Marrëveshjeje në QRA dhe QKB dhe për të siguruar lëshimin e

the form of a Securing Charge over the Charged Shares (as defined above) for the benefit of FIB, only and exclusively for the purpose of facilitating the Release of the Transaction Loan Amount immediately upon transfer of legal title over the Charged Shares to ATI.

**NOW THEREFORE**, the Parties, intending to be legally bound, hereby covenant and agree as follows:

**1. DEFINITIONS AND CONSTRUCTIONS**

**1.1 Definitions**

Wherever used in this Agreement (including in the preamble), the following terms shall have the meanings defined herein:

“**Charged Shares**” means the Existing Shares and any Future Shares.

“**Completion**” means the transfer of title of the Charged Shares from COSMOTE to ATI, registration of such transfer within QRA and receipt of the related extract.

“**Establishment**” or “**Perfection**” (used interchangeably) each means the establishment and perfection of the Securing Charge (or any amendment or supplement thereof) with respect to the Charged Shares in accordance with this Agreement by way of:

- (a) registration of the Securing Charge with (A) the Company's internal share registry and (B) RBS;
- (b) procurement of the issuance of a confirmation of registration and respective certificate from the RBS, certifying the granting (or amendment or supplement) and due registration of the Securing Charge granted hereunder; and
- (c) filing of the Securing Charge Agreement with (A) the QRA and (B) the QKB,

and “**Establish**”, “**Establishing**”, “**Perfect**” and “**Perfecting**” shall be construed accordingly. The Parties agree that COSMOTE will undertake all reasonable endeavors to register this Agreement and the Securing Charge granted hereunder with the QRA and the

konfirmimit të regjistrimit dhe ekstrakteve përkatëse nga QRA-ja dhe QKB-ja, që vërtetojnë dhënien (ose ndryshimin apo shtimin) dhe regjistrimin e Barrës Siguruese objekt të kësaj Marrëveshjeje. Për të qartësuar çdo dyshim, saktësohet se nëse pas depozitimit, QRA-ja dhe/ose QKB-ja refuzojnë, për çfarëdolloj arsyeje, ta regjistrojnë Barrën Siguruese apo të lëshojnë certifikatën që e vërteton këtë regjistrim (nëse kjo certifikatë është e zbatueshme), ky refuzim nuk prek në asnjë mënyrë Krijimin apo Perfeksionimin e Barrës Siguruese dhe nuk përbën shkelje të kësaj Marrëveshjeje nga Barrëdhënësi dhe/ose Pranuesi, meqenëse janë bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme.

“Aksionet Ekzistuese” janë [tetë qind e dymbëdhjetë mijë e nente qind e nentëdhjetë e shtatë (812,997)] aksione të zakonshme të regjistruara, me vlerë nominale prej një mijë lekësh (1.000 Lekë), që përfaqësojnë [99.90%] të kapitalit të Shoqërisë në pronësi të COSMOTE-s, siç përcaktohet në ekstraktin e QKB-së dhe konfirmimin e QRA-së, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.

“Marrëveshja e Huasë” ka kuptimin që i është dhënë në preambulën (A) më sipër.

“Kolaterali Financiar” është barra mbi Aksionet e Kolateralizuara, dhënë nga COSMOTE në favor të FIB-së dhe pranuar nga ATI, në përputhje me Marrëveshjen e Kolateralit Financiar.

“Marrëveshja e Kolateralit Financiar” është marrëveshja e kolateralit financiar lidhur më 17 Prill 2019 midis COSMOTE, në cilësinë e Kolateraldhënesit (siç përkufizohet në këtë Marrëveshje) dhe FIB në cilësinë e Kolateralmarresit (siç përkufizohet në këtë Marrëveshje) dhe ATI-së, në cilësinë e Pranuesit.

“Aksione të Ardhshme” është cdo aksion i kapitalit të Shoqërisë, në pronësi, të blera, ose të regjistruara nga COSMOTE përpara Kompletimit, ose nga ATI pas Kompletimit.

“Ligji për Barrët Siguruese” është Ligji

QKB and procure the issuance of a confirmation of registration and respective extracts from the QRA and the QKB certifying the granting (or amendment or supplement) and due registration of the Securing Charge granted hereunder. For the avoidance of doubt it is clarified that if, upon filing, the QRA and/or the QKB refuse, for any reason whatsoever, to register the Securing Charge or grant the certificate evidencing such registration (if such certificate is applicable), this will not affect in any way the Establishment or Perfection of the Securing Charge and will not result in a breach of this Agreement by the Chargor and/or the Acceptor, provided that all reasonable endeavors have been undertaken.

“Existing Shares” means [eight hundred and twelve thousand, nine hundred and ninety-seven (812,997)] ordinary registered shares, with par value of one thousand leke (1,000 Leke), representing [99.90%] of the capital of the Company owned by COSMOTE, as specified according to the QKB extract and the QRA confirmation attached to this Agreement.

“Facility Agreement” has the meaning ascribed to this term in preamble (A) above.

“Financial Collateral” means the security interest over the Collateralized Shares as provided by COSMOTE in favor of FIB and accepted by ATI pursuant to the Financial Collateral Agreement.

“Financial Collateral Agreement” means the financial collateral agreement between COSMOTE as Financial Collateral Giver (as defined therein), FIB, as Financial Collateral Keeper (as defined therein), and ATI, as Acceptor (as defined therein), dated April 17, 2019.

“Future Shares” means any shares in the capital of the Company owned, acquired or subscribed for, by COSMOTE, before Completion, or by ATI, after Completion.

“Law on Securing Charge” means Law

Nr. 8537, datë 18.10.1999 "Për Barrët Siguruese", ndryshuar herë pas here.

"Barrë" është çdo peng, detyrim pagese, privilegj apo përparësi (përveçse kur lind nga ligjet e detyrueshme), garanci, transferim, konfiskim apo çdo barre tjetër i çfarëdo lloji, ose çdo marrëveshje apo rregullim tjetër që ka si efekt vendosjen e barres mbi ose në lidhje me, apo ndarjen ose rregullime të tjera preferenciale lidhur me Aksionet e Barresuara, por duke përjashtuar (i) çdo barre të dhënë sipas Marrëveshjes së Kolateralit Financiar të së njëjtës datë lidhur midis Palëve dhe (ii) çdo të drejtë parablerjeje që mund t'i jepet një pakice aksionarësh të Shoqërisë lidhur me transferimin e Aksioneve të Barresuara te Pranuesi.

"RBS" është Regjistri i Barrëve Siguruese në Shqipëri.

"Zhbllokimi i Shumës së huase së Transaksionit" ka kuptimin që i është dhënë në preambulën (D) më lart.

"Deklarata e Zhbllokimit" ka kuptimin që i është dhënë në Klauzolën 7.5 të kësaj Marrëveshjeje.

"Detyrimet e Siguruara" janë të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e tashme dhe të ardhshme në momentin që bëhen të shlyeshme, që i përkasin ose që lindin mbi ATI-n (ose, pas Kompletimit, nga palë të tjera të detyruara në Marrëveshjen e Huasë) kundrejt FIB në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë, si faktike, ashtu edhe kontigjente, dhe nëse janë shkaktuar veçmas apo bashkërisht, dhe si principal ose garanci, apo në çdo kapacitet tjetër, së bashku me të gjitha kostot, detyrimet e pagesës dhe shpenzimet e shkaktuara FIB-së lidhur me mbrojtjen, ruajtjen apo ushtrimin e të drejtave të saj përkatëse në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë, apo çdo dokumenti tjetër që i vërteton ose i siguron këto përgjegjësi.

"Periudha e Sigurisë" është periudha që fillon nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje e përfundon në ditën kur i gjithë dhe cdo Detyrim i Siguruar është shlyer plotësisht dhe në mënyrë të pakushtezuar dhe të pakthyeshme.

"Barra Siguruese" është barra siguruese e krijuar mbi Aksionet e Barresuara në

No. 8537 dated 18.10.1999, named "Law on Securing Charges" as amended from time to time.

"Lien" means any pledge, charge, privilege or priority (unless arising by virtue of mandatory laws), encumbrance, assignment, attachment or other security interest of any kind or any other agreement or arrangement having the effect of conferring security upon or with respect to, or any segregation of or other preferential arrangement with respect to the Charged Shares, but excluding (i) any security granted under the Financial Collateral Agreement of the same date between the Parties and (ii) any right of first refusal that may be deemed to be vested in the minority shareholders of the Company in connection with the transfer of the Charged Shares to the Acceptor.

"RBS" means the Albanian Securing Charge Register (*Regjistri I Barreve Siguruese* in Albanian).

"Release of the Transaction Loan Amount" has the meaning ascribed to this term in preamble (D) above.

"Release Statement" has the meaning ascribed in Clause 7.5 hereof.

"Secured Obligations" means all present and future obligations and liabilities at any time due, owing or incurred by ATI (or, after Completion, by other obligors under the Facility Agreement) to FIB under the Facility Agreement, both actual and contingent and whether incurred solely or jointly and as principal or surety or in any other capacity, together with all costs, charges and expenses incurred by FIB in connection with the protection, preservation or enforcement of its respective rights under the Facility Agreement or any other document evidencing or securing such liabilities.

"Security Period" means the period beginning on the date of this Agreement and ending on the day on which all and any Secured Obligations have been unconditionally and irrevocably discharged in full.

"Securing Charge" is the security interest over the Charged Shares in favor

favor të FIB, në cilësinë e Barrëmarrësit, dhe të pranuar nga ATI, në cilësinë e Pranuesit, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, për t'u Vendosur dhe Preferuar në përputhje me këtë Marrëveshje, e cila shërben gjatë Periudhës së Sigurisë si garanci për Detyrimet e Siguruara.

"QKB" është Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri.

"QRA" është Qendra e Regjistrimit të Aksioneve në Shqipëri.

#### 1.2. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

- (a) çdo Palë interpretohet në mënyrë të tillë që të përfshijë edhe pasardhësit në titull, cesionarët e lejuar dhe marresit e lejuar te te drejtave.
- (b) përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti, fjalët që tregojnë njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas; fjalët që tregojnë persona përfshijnë individë, korporata, partneritete dhe persona të tjerë juridikë; dhe referencat ndaj një personi përfshijnë edhe pasardhësit dhe marresit e lejuar te te drejtave.;
- (c) referenca ndaj një marrëveshjeje, duke përfshirë pa kurrfarë kufizimi, Marrëveshjen e Huasë, duhet interpretuar si referencë ndaj asaj marrëveshjeje siç mund të jetë amenduar, ndryshuar, shtuar, rinovuar apo rregulluar herë pas here, duke përfshirë (pa kurrfarë kufizimi) amendamentet, ndryshimet, shtesat, rinovimet dhe rregullimet lidhur me identitetin e Barrëmarrësit dhe/ose natyrën ose shumën e Detyrimeve të Siguruara.
- (d) referenca ndaj një ligji, rregulloreje apo statuti interpretohet si referencë ndaj atij ligji, rregulloreje apo statuti, siç mund të jetë amenduar, ndryshuar apo shtuar herë pas here;
- (e) krerët janë vendosur vetëm për qëllime reference dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje; dhe

of FIB, as the Chargee, and hereby accepted by ATI, as the Acceptor, in accordance with applicable laws and regulations, to be Established and Perfected in accordance with this Agreement, and during the Security Period shall serve as a security for the Secured Obligations.

"QKB" means the National Business Center of Albania (*Qendra Kombetare e Biznesit* in Albanian).

"QRA" means the Share Registration Center of Albania (*Qendra e Regjistrimit te Aksioneve* in Albanian).

#### 1.2. Interpretation

In this Agreement:

- (a) each Party shall be construed so as to include its successors in title, permitted assigns and permitted transferees;
- (b) unless the context otherwise requires, words denoting the singular include the plural and vice versa, words denoting persons include individuals, corporations, partnerships and other legal persons and references to a person include its successors and permitted assigns;
- (c) a reference to an agreement, including, without limitation, the Facility Agreement, shall be construed as a reference to such agreement as it may be amended, varied, supplemented, novated or assigned from time to time including (without limitation) amendments, variations, supplementations, novations or assignments relating to the identity of the Chargee and/or the nature or amount of the Secured Obligations;
- (d) a reference to a law, a regulation or a statute shall be construed as a reference to such law, regulation or statute as it may be amended, varied or supplemented from time to time;
- (e) the headings are inserted for convenience of reference only and shall not affect the interpretation of this Agreement; and

<p>(f) “përfshirë” dhe “përfshin” interpretohen së bashku me togfjalëshin “pa kurrfarë kufizimi” edhe kur nuk ndiqet nga ky i fundit.</p>	<p>(f) “including” and “include” shall be deemed to be followed by “without limitation” where not so followed.</p>
<p><b>2. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE DERI NË ZHBLLOKIMIN E SHUMËS SË HUASË SË TRANSAKSIONIT</b></p>	<p><b>2. RIGHTS AND OBLIGATIONS OF THE PARTIES UP TO THE RELEASE OF THE TRANSACTION LOAN AMOUNT</b></p>
<p>Pavarësisht çdo dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje, Palët bien dakord si më poshtë:</p>	<p>Notwithstanding any other provision of this Agreement the Parties agree as follows:</p>
<p>2.1. COSMOTE e lidh këtë Marrëveshje në cilësinë e Barrëdhënësit me qëllimin e vetëm për të lehtësuar Perfeksionimin e Barrës Siguruese përpara Zhbllokimit të Shumës së Huasë së Transaksionit.</p>	<p>2.1. COSMOTE is entering into this Agreement as Chargor for the sole purpose of facilitating the Perfection of the Securing Charge prior to the Release of the Transaction Loan Amount.</p>
<p>2.2. Barrëmarrësi angazhohet dhe zotohet ndaj COSMOTE-s, në cilësinë e Barrëdhënësit, se deri në zhbllokimin e Shumës së Huasë së Transaksionit:</p>	<p>2.2. The Chargee commits and undertakes to COSMOTE, as Chargor, that, up to the Release of the Transaction Loan Amount:</p>
<p>(a) nuk do të ekzekutoje Barrën Siguruese kundrejt COSMOTE për asnjë lloj arsyeje (duke përfshirë edhe mospërbushjen e detyrimeve nga ATI) dhe mjeti i vetëm ligjor i së cilës gjatë periudhës së lartpërmendur është pezullimi ose ndërprerja e Zhbllokimit të Shumës së Huasë së Transaksionit, ose çdo masë tjetër, sic parashikohet në Marrëveshjen përkatëse Escrow;</p>	<p>(a) it will not, for any reason whatsoever (including a default of ATI) enforce the Securing Charge against COSMOTE, its only remedy during the above period being the suspension or termination of, or any other measure as provided for in the Escrow Agreement in relation to, the Release of the Transaction Loan Amount;</p>
<p>(b) nuk do të ushtroje të drejtën e tij si Barrëmarrës në asnjë lloj mënyre që ndikon në përmbushjen e detyrimeve të COSMOTE-s në kuadrin e Marrëveshjes së Shitblerjes dhe se nuk do të ndërmarri asnjë veprim që pengon ushtrimin e të drejtave të COSMOTE-s si aksionar (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në, transferimin e aksioneve, thirrjen e mbledhjeve të aksionarëve, ushtrimin e të drejtës së votës, shpërndarjes të, dhe të drejtat mbi dividendët)</p>	<p>(b) it will not exercise its rights as a Chargee in any way affecting the performance of COSMOTE’s obligations under the SPA and it will refrain from any action obstructing the exercise of any shareholder’s rights of COSMOTE (including, but not limited to, transfer of shares, convocation of shareholders’ meeting, exercise of voting rights, distribution of, and title to dividends).</p>
<p>2.3. Barrëmarrësi heq dorë, për periudhën që i paraprin Zhbllokimit të Shumës së Huasë së Transaksionit, nga të gjitha të drejtat e dhëna nga legjislacioni shqiptar lidhur me Aksionet e Barresuara (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në, të drejtën për të ekzekutuar Barrën Siguruese, të drejtën</p>	<p>2.3. The Chargee waives, for the period prior to the Release of the Transaction Loan Amount, all rights conferred to it by Albanian law in respect of the Charged Shares (including, but not limited to, the right to enforce the Securing Charge, voting rights over the Charged Shares,</p>



e votës mbi Aksionet e Barresuara, te drejten mbi dividendët).

2.4. Barrëmarrësi zotohet dhe angazhohet kundrejt COSMOTE-s, në cilësinë e Barrëdhënësit, per të marrë të gjitha hapat e nevojshme për çregjistrimin e Barrës Siguruese nga të gjitha regjistrat ku është regjistruar dhe ta lirojë COSMOTE-n nga çdo dhe të gjitha detyrimet në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, nëse transferimi i Aksioneve të Barresuara te ATI nuk kryhet në përputhje me Marrëveshjen e Shitblerjes për çfarëdolloj arsyeje.

2.5. Barrëmarrësi dhe ATI marrin përsipër që te mbajne COSMOTE-ne të padëmtuar ndaj çdo dhe të gjitha pretendimeve kundër COSMOTE-s, në cilësinë e Barrëdhënësit, që lindin nga Marrëveshja, përveçse kur këto pretendime rrjedhin nga neglizhenca e rende e COSMOTE-së ose mospërbushja e qëllimshme e detyrimeve.

### 3. DEKLARIMET DHE GARANCITË

#### 3.1. Deklarimet dhe Garancitë

Nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, COSMOTE deklaron dhe garanton Barrëmarrësin se:

- (a) është pronari dhe perfituesi ligjor i Aksioneve të tij Ekzistuese;
- (b) Shoqëria ka një kapital të regjistruar prej tetë qind e trembëdhjetë milion e tetë qind e njëzet e dy mijë Lekësh (813.822.000 Lekë), i ndarë në tetë qind e trembëdhjetë mijë e tetë qind e njëzet e dy (813.822) aksione të zakonshme dhe të regjistruara, me vlerë nominale prej një mijë lekësh (1.000 Lekë), që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë;
- (c) Aksionet Ekzistuese të Shoqërisë janë emetuar në mënyrë të ligjshme dhe të vlefshme dhe Shoqëria ka bërë regjistrimet e nevojshme lidhur me Aksionet Ekzistuese në regjistrat përkatës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- (d) Aksionet Ekzistuese janë regjistruar dhe të gjithë aksionarët kanë derdhur vlerat përkatëse; dhe
- (e) nuk ka asnjë Barrë mbi Aksionet

title to dividends).

2.4. The Chargee commits and undertakes to COSMOTE, as Chargor, that if the transfer of the Charged Shares to ATI does not take place in accordance with the SPA for any reason whatsoever, it will take all necessary steps reasonably requested to assist with the deregistration of the Securing Charge from all registries where the Securing Charge has been registered and the Chargee shall release COSMOTE from any and all its obligations under this Agreement.

2.5. The Chargee and ATI undertake to hold COSMOTE harmless against any and all claims made against COSMOTE, as Chargor, arising out of this Agreement, except where such claims are a result of COSMOTE's gross negligence or willful default.

### 3. REPRESENTATIONS AND WARRANTIES

#### 3.1. Representations and Warranties

As of the date of this Agreement, COSMOTE hereby represents and warrants to the Chargee that:

- (a) it is the legal and beneficial owner of the Existing Shares.
- (b) the Company has a registered capital of eight hundred and thirteen million, eight hundred and twenty-two thousand Leke (813,822,000 Leke) divided into eight hundred and thirteen thousand, eight hundred and twenty-two (813,822) ordinary and registered shares, with par value of one thousand leke (1,000 Leke), representing 100% of the capital of the Company;
- (c) the Existing Shares of the Company have been duly and validly issued and the Company has made the necessary entries related to the Existing Shares in the relevant registers, as per the requirements of applicable law;
- (d) all Existing Shares are fully subscribed for and paid-in; and
- (e) there is no Lien over the Existing

Ekzistuese, dhe nuk ka mbetur pezull as regjistrimi i ndonje Barre, dhe as i veprimeve për krijimin, vendosjen apo perfeksionimin e një Barre të ndërmarrë nga COSMOTE, ose në dijeni të COSMOTE-s, apo të një personi tjetër.

### 3.2. Besueshmëria dhe Saktësia

- (a) COSMOTE i garanton Barrëmarrësit se çdo deklaratë dhe garanci e dhënë në Seksionin 3.1 është e vërtetë dhe e saktë që prej datës së lidhjes së Marrëveshjes dhe që prej datës së Krijimit dhe Perfeksionimit të saj dhe se asnjë deklaratë dhe garanci nuk përjashton asnjë çështje që i bën këto deklaratë dhe garanci të pavërteta ose keqinformuese nga pikëpamja materiale.
- (b) COSMOTE pranon se Barrëmarrësi e ka lidhur këtë Marrëveshje në mbështetje dhe në besim të plotë me çdo deklaratë dhe garanci.

## 4. DETYRIMET E SIGURUARA DHE INTERESI I SIGURISË

### 4.1. Detyrimet e Siguruara sipas Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje lidhet për të siguruar dhe siguron pagesën e plotë të të gjitha Detyrimeve të Siguruara.

### 4.2. Interesi i Barresuar

- (a) Për të siguruar pagesën dhe përmbushjen me përpikëri dhe të plote të Detyrimeve të Siguruara, COSMOTE në cilësinë e Barrëdhënësit, krijon barrën siguroese sipas Ligjit për Barrët Siguroese mbi Aksionet e Barresuara në favor të FIB në cilësinë e Barrëmarrësit ("**Barra Siguroese**") dhe ndërmerr të komplete Krijimin dhe Perfeksionimin si barres siguroese të rradhes se pare të Aksioneve të Barresuara sipas dhe në përputhje me Klauzolën 1.1 të kësaj Marrëveshjeje.
- (b) Aksionet e Barresuara do të shërbejnë si barres siguroese e rradhes se parë në favor të Barrëmarrësit për gjatë gjithë

Shares, nor is the registration of such Lien pending, nor have any actions for the creation, establishment or perfection of a Lien been undertaken by COSMOTE or, to the knowledge of COSMOTE, by any other person.

### 3.2. Reliance and Accuracy

- (a) COSMOTE warrants to the Chargee that each of the respective representations and warranties in Section 3.1 is true and accurate as of the date of this Agreement and as of the date of its Establishment and Perfection and that no representation or warranty omits any matter that makes any of such representations or warranties untrue or materially misleading.
- (b) COSMOTE acknowledges that the Chargee has entered into this Agreement on the basis of, and in full reliance on, each such representation and warranty.

## 4. OBLIGATIONS SECURED AND SECURITY INTEREST

### 4.1. Obligations Secured under the Agreement

This Agreement is made in order to secure, and secures, the payment in full of all the Secured Obligations.

### 4.2. Security Interest

- (a) In order to secure the punctual payment and performance of the Secured Obligations, COSMOTE, as a Chargor, hereby creates a securing charge under the Law on Securing Charge with respect to the Charged Shares in favor of FIB, as the Chargee (the "**Securing Charge**"), and undertakes to complete its Establishment and Perfection as a first ranking security interest in the Charged Shares pursuant to and in accordance with clause 1.1 of this Agreement.

- (b) The Charged Shares shall continuously serve as a first ranking security in favor of the Chargee during the Security

Periudhës së Sigurisë.

- (c) ATI njih dhe pranon në këtë Marrëveshje se Aksionet e Barresuara do të vijojnë të shërbejnë si barre siguruese në favor të Barrëmarrësit pas Kompletimit dhe se çdo aksion i Shoqërisë, titulli i pronësise mbi të cilin mund t'i transferohet shoqërisë ATI si rezultat i Transaksionit, ose i çdo transaksioni tjetër, si dhe çdo Aksion të Ardhshëm, është subjekt i Barrës Siguruese në favor të Barrëmarrësit.

4.3. Sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, COSMOTE dhe ATI pranojnë dhe bien dakord që të mos krijojnë, apo të përpiqen të krijojnë, pa pëlqimin me shkrim të Barrëmarrësit ndonjë Barrë lidhur me Aksionet e Barresuara, me përjashtim të Kolateralit Financiar, dhe të mos ndërmarrin asnjë veprim që pengon ushtrimin e të drejtave të Barrëmarrësit në këtë Marrëveshjeje, deri në transferimin e Aksioneve të Barresuara nga COSMOTE te ATI.

4.4. Sipas kufizimeve të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të drejtat e Barrëmarrësit të parashtruara këtu janë të përvokueshme përgjate gjithë Periudhës së Sigurisë.

## 5. DETYRIMET E BARRËDHËNËSIT DHE PRANUESIT

5.1. Barra Siguruese mbi Aksionet e Barresuara te COSMOTE vendoset duke certifikuar titullin e pronësisë siç parashikohet në Ligjin për Barrët Siguruese dhe rradha e Barrës Siguruese mbi Aksionet Ekzistuese përcaktohet nga data e regjistrimit të Barrës Siguruese në RBS.

5.2. Barrëdhënësi dhe Pranuesi garantojnë dhe pranojnë se çdo transferim i pronësisë mbi Aksionet e Barresuara, pavarësisht menyres se transferimit te pronësise (p.sh dhurim, trashëgimi, marrëveshje martesore etj.) nuk ndikon në të drejtat e Barrëmarrësit lidhur me Barrën Siguruese ose Aksionet e Barresuara në këtë Marrëveshje.

5.3. Barrëmarrësi nepermjet kesaj Marreveshje bie dakord, delegon dhe autorizon Barrëdhënësin ta depozitojë dhe regjistrojë Marrëveshjen Siguruese në

Period.

- (c) ATI hereby acknowledges and accepts that the Charged Shares will continue to serve as a security in favor of the Chargee after the Completion and that any shares of the Company the title over which may be transferred to ATI as a result of the Transaction or as a result of any other transaction, as well as any Future Shares, will be subject to the Securing Charge in favor of the Chargee.

4.3. Subject to the provisions of this Agreement, each of COSMOTE, until the transfer of the Charged Shares from COSMOTE to ATI, and ATI, thereafter, hereby acknowledges and agrees that, without the explicit written consent of the Chargee, it shall not create or try to create any Lien with respect to the Charged Shares, with the exception of the Financial Collateral, and will refrain from any action obstructing the exercise of the rights of Chargee under this Agreement.

4.4. Subject to the limitations herein, all rights of the Chargee under this Agreement are irrevocable during the Security Period.

## 5. OBLIGATIONS OF THE CHARGOR AND THE ACCEPTOR

5.1. The Securing Charge over the Charged Shares shall be established upon COSMOTE certifying the ownership title as provided by Law on Securing Charges and the rank of the Securing Charge on Existing Shares shall be determined by the date of registration of the Securing Charge in the RBS.

5.2. Each of the Chargor and the Acceptor hereby warrants and acknowledges that any transfer of ownership over the Charged Shares, irrespective of the employed mechanism (e.g. donation, inheritance, marriage settlement, etc.), shall not affect the Chargee's rights with respect to the Securing Charge or the Charged Shares under this Agreement.

5.3. The Chargee hereby agrees, delegates and authorises the Chargor to file and register this Securing Charge Agreement with the RBS for the purpose of the establishment

RBS për qëllimet e krijimit dhe perfeksionimit të Barrës Siguruese (ose çdo ndryshim apo shtim të saj) lidhur me Aksionet e Barresuara, si dhe delegon te drejten e perfaqesimit dhe autorizon palët e treta për të kryer sa më sipër.

## 6. EKZEKUTIMI I BARRËS SIGURUESE

6.1 COSMOTE dhe ATI nepermjet kesaj Marreveshjeje njohin dhe pranojnë se, në rast të përshpejtimit të huasë, në përputhje me termat e Marrëveshjes së Huasë, dhe në çdo kohë pergjatë Periudhës së Sigurisë, por vetëm pas Zhbllokimit të Shumës së Huasë së Transaksionit, Barrëmarrësi ka të drejtë, në diskrecion të plotë dhe pa qenë nevoja të njoftojë paraprakisht COSMOTE-n ose ATI-n ta ekzekutojë Barrën Siguruese për të përmbushur Detyrimet e Siguruara, pa qenë nevoja të ndiqet ndonjë procedurë për ekzekutimin vullnetar apo të detyrueshëm përmes gjykatave apo përmbaruesve, siç aplikohet per ekzekutimin e garancive te formave te tjera sipas legjislacionit shqiptar.

6.2. Barra Siguruese nuk është objekt ekzekutimi për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të tjera të COSMOTE-s dhe përpara Zhbllokimit të Shumës së Huasë së Transaksionit. Barra Siguruese, sipas kufizimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje, është e ndare dhe nuk mund të ekzekutohet nga persona të tretë, përveç barrëmarrësit, pavarësisht:

- (a) fillimit ose vijimit të procedurave të paafësisë pagueuse ose likuidimit, apo masave ndreqëse lidhur me COSMOTE-n ose ATI-n; apo
- (b) vendosjes së masës së sigurisë, sekuestros, apo urdhrave të ngjashëm gjyqësorë ose ekzekutivë, ose vendimeve lidhur me të drejtat dhe detyrimet mbi Barrën Siguruese; apo
- (c) çdo transferimi, tjetërsimi ose konfiskimi të pretenduar të Barrës Siguruese.

6.3. Sipas kufizimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje, COSMOTE dhe ATI njohin dhe pranojnë se Barrëmarrësi ka të drejtë ta ekzekutojë Barrën Siguruese pavarësisht:

and perfection of the Securing Charge (or any amendment or supplement thereof) with respect to the Charged Shares as well as to delegate and authorize third parties to perform the above.

## 6. ENFORCEMENT OF THE SECURING CHARGE

6.1 Each of COSMOTE and ATI hereby acknowledges and recognises that the Chargee shall, in case of acceleration of the loan in accordance with the terms of the Facility Agreement, at any time during the Security Period, but only after the Release of the Transaction Loan Amount, have the right, at its own discretion and without the need to provide prior notice to COSMOTE or ATI, to enforce the Securing Charge to meet any of the Secured Obligations, without the need to follow any procedures for voluntary or mandatory enforcement using courts and bailiffs as applicable to other forms of guarantees, under the Albanian legislation.

6.2. The Securing Charge is not subject to enforcement because of the non-fulfillment of the other obligations of COSMOTE and before the Release of the Transaction Loan Amount. Subject to the limitations foreseen herein, the Securing Charge is separate and may not be enforced by any third persons, other than the Chargee, regardless of:

- (a) the initiation or continuation of any insolvency or winding-up proceedings or remedial measures with respect to COSMOTE or ATI; or
- (b) the imposition of any security measure, seizure or similar, judicial or execution order, or decision related to the rights and obligations associated with the Securing Charge; or
- (c) any alleged transfer, other disposal, or attachment of the Securing Charge.

